



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Shtator, 2017

Kryeministri Haradinaj u takua me përfaqësues të SBASHK-ut Gatishmëri për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe këshilltari për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri janë takuar me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj dhe anëtarë të kabinetit të tij. Kryeministri Haradinaj është shprehur se çmon lartë angazhimet e punëtorëve e të arsimit në të ... (faqe 5)

Takim njohës me Ministrin e MASHT, z. Shyqiri Bytyqi

Ministri Bytyqi premton se përmes dialogut me SBASHK-un do të zgjidhen të gjitha çështjet e ngritura



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me këshilltarin për organizim(faqe 5)

SBASHK-u u takua me mësimdhënës dhe me kryetarin e Rahovecit z.Idriz Vehapi

Kryetari Vehapi shpreh respekt të lartë për angazhimet e SBASHK-ut

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj bashkë me(faqe 9)

Intervistë me drejtoren e shkollës fillore "Pjetër Bogdani" Prishtinë, Jehona Oruçi

Bashkëpunimi, korrektësia dhe respekti i ndërsjellë sjell suksese

Jehona Oruçi së shpejti do ta ketë titullin e merituar master i arteve. Ajo tani me shumë vullnet ... (faqe 3)

SBASHK –u u takua me Ministrin Kujtim Gashi

Ministri Gashi do të bashkëpunojë ngusht me SBASHK-un për sektorin e kulturës



Me qëllim që të krijohet atmosferë e mirë e korrekte për dialog lidhur me çështjet aktuale ... (faqe 6)



Editorial

Kur vjen 5 Tetori – festa e mësuesve të tërë botës



Në çdo 5 tetor anëtarët e SBASHK-ut i bashkohen në aktivitete miliona kolegëve të tyre anë e kënd botës. Në këtë ditë mësuesit nëpër shtetet e tërë botës kremtojnë, por edhe lartësojnë kujtimin për ngjarjet dhe emrat e shquar të arsimit nacional e botëror. Në këtë shpalesje kujtimesh edhe SBASHK-u ndalet të momente të lavdisë . Kujton me respekt të lartë mësuesit e parë të shkollës shqipe në Korçë, kujton edhe vitet e 90-ta, kur mësimit në Kosovë u kthyen në një digë të fuqishme dhe mbrojtën arsimin shqip nga furtunat e pushuesit. Ata mbrojtën ëndrrën për ditë më të mira dhe kjo ëndërr u bë realitet falë luftës heroike të bijve e bijave më të mira të atdheut që me emblemën e UÇK-së i sollën lirinë këtij trualli dhe ia kthyen buzëqeshjen

fëmijëve të Kosovës . Liria erdhi në Kosovë dhe SBASHK-u vazhdoi misionin në shërimin e plagëve. Vazhdoi rrugëtimin në misionin e shenjtë të edukimit e arsimit të brezave. SBASHK-u vazhdon të jetë zë i mësimit të Kosovës dhe pjesë e nderuar e Internacionales Botërore të Arsimit.

Të nderuar pjesëmarrës jemi ne të 32 milionë sindikalistët, që në kuadër të Internacionales Botërore të Arsimit bashkëpunojnë dhe solidarizohen në përpjekjet e vazhdueshme për të realizuar kërkesat e anëtarësisë dhe për të kontribuar maksimalisht në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë.

Duke kremtuar 5 tetorin, këtë datë të madhe të arsimit botëror, SBASHK nis të vë në letër idetë që edhe ditën kombëtare të mësuesit- 7 Marsin ta festojmë me shumë aktivitete e duke lartësuar kujtimin për punën e madhe të mësimit nëpër vite e dekada në arsimimin e edukimin e drejtë të brezave.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me drejtoreshën e shkollës fillore “Pjetër Bogdani” Prishtinë, Jehona Oruçi

Bashkëpunimi, korrektësia dhe respekti i ndërsjellë sjell suksese



Jehona Oruçi së shpejti do ta ketë titullin e merituar master i arteve. Ajo tani me shumë vullnet kryen detyrën e drejtoreshës në shkollën “Pjetër Bogdani”.

Ajo thotë se suksesi i plotë në udhëheqjen e mirë të një institucioni arsimor mund të arrihet duke siguruar një kulturë të shëndoshë të

bashkëpunimit në mes të nxënësve, administratorëve, mësuesve dhe prindërve.

Arsimimi sot:

Kush është Jehona Oruçi?

Jehona:

Jehona Oruçi, e lindur në Prishtinë me datë 22 qershor 1979, diplomoi në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës në vitin 2004 dega Pikturë. Në të njëjtin Fakultet ka përfunduar me sukses Masterin dhe tani është në fazën e mbrojtjes së temës për të fituar titullin Master i arteve.

Në vitin 2006 filloi punën në shkollën fillore të mesme të ulët “Hilmi Rakovica” në Prishtinë, në cilësinë e arsimtares së lëndës Edukatë Figurative për të vazhduar pastaj nga viti 2013 në Shkollën fillore të mesme të ulët “Pjetër Bogdani” Prishtinë. Në vitin 2015 ju besua detyra e drejtoreshës së kësaj shkolle, detyrë të cilën me përkushtim e me plot sukses e kryen edhe tani.

Në vitin 2009 u zgjodh Sekretare e Përgjithshme në Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK). Ajo, edhe krahas shumë angazhimeve në shkollën e saj, vazhdon të kontribuojë në SBASHK duke kryer detyrën si sekretare e përgjithshme pa pagë, që i është besuar nga Këshilli Drejtues.

Arsimimi sot:

Si e vlerësoni fillimin e këtij viti shkollor në shkollën që drejtoni, por edhe në Kosovë në përgjithësi?

Jehona:

Meqenëse përgatitjet për vitin shkollorë bëhen gjatë muajit gusht, edhe shkollën tonë viti i ri shkollor e gjeti mjaft mirë të përgatitur. Risi e këtij viti, si në

shkollën tonë, po ashtu edhe në nivelin shtetëror është Korniza e re e Kurrikulës së Kosovës. Me ç’rast janë bërë përgatitjet për realizimin e kurrikulës së re duke përfshirë përpilimin e broshurave për informimin e prindërve rreth kësaj kurrikule, trajnimi i mësuesve për nivelin parafillor, klasat e para dhe klasat e gjashta, hartimi i planprogrameve, pajisja me materiale të nevojshme rreth kurrikulës si Kornizën e Kurrikulës, Kurrikulën Bërthamë, si dhe Udhëzuesit për Fushat e Kurrikulës.

Gjatë përgatitjeve për realizimin sa më të mirë të kurrikulës mësuesit janë treguar bashkëpunues, kreativ, praktik duke shprehur interesim për shkëmbim të njohurive dhe përvojave si nga mësuesit në nivel shkolle po ashtu edhe me shkolla tjera.

Kurrikula e re u shtri në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës në nivelet e lartçekura dhe mendoj se të njëjtat sfida i kanë përcjell edhe shkollat tjera. Kjo kurrikulë është e bazuar në zhvillimin e kompetencave përderisa kurrikula paraprake ishte e bazuar në përmbajtje.

Përparësitë e kurrikulës së re janë: ngritja e nivelit të bashkëpunimit, fleksibiliteti i përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit, përdorimit të metodologjive të reja të mësimit, hartimi i planeve në korrelacion me lëndët e tjera, mënyrat dhe format e vlerësimit duke u bazuar në përdorimin e shumë instrumenteve për vlerësimin jo që nuk ishte praktikë në të kaluarën por tani është më specifike duke u bazuar në listën e kontrollit. Gjithashtu mund të veçojmë se vlerësimi përfundimtar do të ndodhë pas përfundimit të çdo periudhe, ku gjithsej janë tri periudha si shtator-dhjetor, janar –mars, prill-qershor.

Arsimimi sot:

Cilat janë sfidat kryesore të një drejtori të shkollës?

Jehona:

Është besimi im se ne jemi të përgjegjshëm për të siguruar, një mjedisi të sigurt dhe fizikisht të rehatshëm ku të gjithë nxënësit dëshirojnë të kenë ndjenjën e përkatësisë, si dhe procesin mësuesor të ndjejnë si pjesë të kënaqësisë shpirtërore dhe jo ta marrin si obligim ligjor. Prandaj nxënësve duhet të ju përmbushim nevojat themelore para se ata të përqendrohen plotësisht në procesin e të mësuarit. Dhe krejt kjo mund të arrihet duke siguruar një kulturë të shëndoshë të bashkëpunimit në mes të nxënësve,

administratorëve, mësimeve dhe prindërve. Unë besoj se është e rëndësishme për mua si një udhëheqës të komunikoj me nxënësit, mësuesit çdo ditë dhe të pranoj shqetësimet e tyre për qëllim të realizimit të mësimit dhe mësimit sa më efektive.

Drejtori përballet me sfida të natyrave të ndryshme pasi që ai është udhëheqës dhe menaxheri i të gjitha proceseve në shkollë.

Ndër sfidat mund të përmendim; sigurimi i ambientit sa më të përshtatshëm për mësime dhe mësime, avancimi dhe zhvillimi profesional të mësimeve, mësime kabinetik, mësime përmes TIK-ut, etj.

Arsimimi sot:

Cili është sot roli i femrës në sindikatë?

Jehona:

Femrat duhet të jenë të përfaqësuara denjësisht në gjitha fushat e veçanërisht në SBASHK, duke ditur që pjesa dërmuese i takojnë profilit të arsimit. Sindikata e Bashkuar Arsimit Shkencës dhe Kulturës së Kosovës ka për qëllim të mbroj të drejtat e punëtorëve të arsimit, njëkohësisht të bëjë avancimin e tyre duke u fokusuar në zhvillimin profesional të mësimeve për të ngritur cilësinë si në mësime po ashtu edhe në mësime. Andaj edhe femrat edhe meshkujt në këtë rast janë të barabartë dhe kanë përgjegjësi të njëjtë në raport me të drejtat e tyre. Por unë fuqimisht besoj se zëri i gruas duhet të dëgjohet edhe në sindikatë me një rol aktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të punëtorëve të arsimit. E gjitha mund të arrihet duke vetëdijësuar anëtarët e gjinisë femërore të sindikatës se pjesëmarrja aktive e tyre fuqizon rolin e femrës në shoqëri dhe po ashtu në sindikatë.

Arsimimi sot:

Ku është më lehtë të jesh udhëheqës, në sindikatë apo në institucion arsimor?

Jehona:

Të jesh udhëheqës në shkollë është pak më ndryshe nga ajo në sindikatë. Çdo punë ka përgjegjësinë e vet, mirëpo udhëheqja e institucionit arsimor, si shkolla në këtë rast, kërkon përkushtim dhe qasje të veçantë ndaj mësimeve, nxënësve, prindërve dhe stafit të shkollës si në organizim, strukturë, rregulla të përcaktuara qartë, politika dhe pritshmëri arsimore, të cilat duhet të jenë të qëndrueshme dhe të duhura.

Ndërsa të jesh udhëheqës në sindikatë jo që vetëm ka përgjegjësi të lartë, por ka të bëjë me organizimin, përfaqësimin e anëtarësisë në nivel shtetëror. Detyra e sekretares së sindikatës është një rol i veçantë për arsimin në përgjithësi.

Duke e ditur se Sindikata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve përmes zhvillimit të dialogut social, duke krijuar kushte të favorshme për të ndihmuar mësuesit në zhvillimin profesional, gjë e cila do të kontribuoj në ngritjen e cilësisë së arsimit pasi që një ekonomi globale varet nga një arsim i lartë, prandaj unë mendoj se duhet punuar në ngritjen e cilësisë, në avancimin e mësimit dhe mësimit për të arritur synimet tona.

Arsimimi sot:

Cilat arritje të SBASHK-ut do t'i veçonit?

Jehona:

SBASHK-u ka shënuar shumë arritje në shërbim të anëtarësisë dhe realizimit të kërkesave të tyre legjitime. Unë do të veçoja si arritje të madhe edhe nënshkrimin e Kontratës Kolektive, Kontratën Individuale të punës në kohë të pacaktuar, arritjen e 0.5 % për çdo vit shërbimi, nënshkrimin e më shumë se 100 marrëveshjeve me bizneset për zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarësinë e shumë të tjera.

Arsimimi sot:

Çka duhet të bëjë SBASHK-u tani e tutje për anëtarësinë e vet?

Jehona:

Konsideroj se një ndër prioritetet kryesore të SBASHK-ut është realizimi në tërësi i Kontratës Kolektive dhe takimi e bashkëbisedat me anëtarët kudo nëpër komunat e Kosovës dhe në Universitete

Duke e ditur se barazia gjinore është një faktor kyç në përfaqësimin sindikal, duhet të ndodhë edukimi për barazinë e cila është pjesë e rëndësishme e bërjes së politikave arsimore.

Arsimimi sot:

Cili është mesazhi juaj për femrën që të angazhohet më shumë në rrjedhat shoqërore dhe në sindikatë?

Jehona:

Femra në shoqëri si dhe në sindikatë duhet të ketë rol aktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, sepse vetëm me pjesëmarrje aktive qëllimet dhe synimet do të arrihen.

Gjatë muajit

Kryeministri Haradinaj u takua me përfaqësues të SBASHK-ut **Gatishmëri për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit**



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe këshilltari për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri janë takuar me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj dhe anëtarë të kabinetit të tij.

Kryeministri Haradinaj është shprehur se çmon lartë angazhimet e punëtorëve e të arsimit në të kaluarën

dhe tani në misionin e tyre të shenjtë për arsimimin dhe edukimin e brezave duke shtuar se ndjehet mirë që përfaqësuesit e SBASHK-ut e kanë përgëzuar për detyrën në emër të gjithë punëtorëve të arsimit dhe se ai bashkë me kabinetin e tij do të kenë në vazhdimësi takime të punës me përfaqësues të SBASHK-ut për të diskutuar për të gjitha çështjet që lidhen me sektorin e arsimit dhe për të gjetur zgjidhje konkrete për të gjitha çështjet.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut i kanë uruar detyrën Kryeministrin në emër të gjithë të punësuarve në arsim dhe i kanë shpalosur angazhimet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe përkushtimin për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim. Në bashkëbisedë me Kryeministrin Haradinaj përfaqësuesit e SBASHK-ut janë ndalur veçmas të çështja e Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

Takim njohës me Ministrin e MASHT, z. Shyqiri Bytyqi

Ministri Bytyqi premtan se përmes dialogut me SBASHK-un do të zgjidhen të gjitha çështjet e ngritura



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me këshilltarin për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe asistenten dhe zyrtaren për komunikim me anëtarësinë e SBASHK-ut dhe me publikun, Vlora

Rexhepi Berisha kanë pasur takimin e parë njohës në Ministrin e ri në MASHT, Shyqiri Bytyqi dhe anëtarët e Kabinetit të tij. Ata i kanë uruar detyrën Ministrin të ri duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në shërim të anëtarësisë. Kryetari Jasharaj ka kujtuar Ministrin Bytyqi se janë shënuar arritje , por ende ka çështje që duhen zgjidhur me angazhime të përbashkëta duke kujtuar Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet 90-ta dhe çështje nga Kontrata Kolektive të cilat ende nuk kanë gjetur zgjidhje nga institucionet lokale të pushtetit. Ministri Bytyqi ka shprehur gatishmërinë e plotë për të bashkëpunuar ngushtë me SBASHK-un për zgjidhjen me dialog të të gjitha çështjeve të shtruar dhe për të shtuar bashkëpunimin edhe për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim.

SBASHK –u u takua me Ministrin Kujtim Gashi

Ministri Gashi do të bashkëpunojë ngusht me SBASHK-un për sektorin e kulturës

Me qëllim që të krijohet atmosferë e mirë e korrekte për dialog lidhur me çështjet aktuale në sektorin e kulturës, kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj , i shoqëruar nga këshilltari për organizim të brendshëm kanë vizituar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe janë takuar me Ministrin Kujtim Gashi. Kryetari i SBASHK-ut , pasi i ka uruar detyrën e re, Ministrit Gashi , e ka informuar atë me shqetësimet e ngritura nga anëtarësia e SBASHK-ut që vijnë nga sektori i kulturës dhe ka treguar se është duke u punuar drafti i Kontratës Kolektive për këtë sektor, draft ky i cili do të analizohet edhe nga komisioni i kësaj ministrie në mënyrë që të krijoheshin kushtet që ajo edhe të nënshkruhet nga Ministri Gashi dhe kryetari i SBASHK-ut.

Ministri Kujtim Gashi është shprehur i gatshëm që të bashkëpunojë me SBASHK-un për të gjitha çështjet

dhe në shërbim të mbrojtjes së interesave të punëtorëve të kulturës. Ai është shprehur se Ministria



që drejton do të kryej të gjitha obligimet që i takojnë në shërbim të kulturës në Kosovë.

Interesim i madh i anëtarësisë për zgjedhjet e SBASHK-ut në nivele komunale

Kuvende zgjedhore të SAF e SAM në Pejë, Deçan, Podujevë, Skenderaj, Mitrovicë e Lipjan

Shtatori ka shënuar nismën e agjendës për mbajtjen e Kuvendeve zgjedhore të SAF e SAM nëpër komunat e Kosovës. Ky aktivitet në disa komuna ka përfunduar me sukses të plotë dhe gëzon fakti se kudo vërehet një frymë e mobilizimit dhe respekti i lartë për SBASHK-un. Kështu ishte edhe në **Pejë**. Në



ambientet e Asamblesë komunale anëtarët e Kuvendit të SAF e SAM të kësaj komune kanë dëgjuar me vëmendje fjalën hyrëse dhe raportin e punës e atë financiar që e ka prezantuar kryetari Isuf Lajçi.

Pas kësaj janë bërë zgjedhjet për kryetar, nënkryetar, anëtarë të kryesisë, anëtarë të Komisionit mbikëqyrës, për delegatë të Kongresit të SBASHK-ut dhe për

anëtarë të Këshillit Drejtues.



Kuvendin e SAF e SAM të kësaj komune do ta udhëheq edhe në katër viet e ardhshme, Isuf Lajçi i ndihmuar nga nënkryetarja Shpresa Nushi. Anëtarë të Kryesisë janë zgjedhur: Hysen Uka, Ismet Shala, Avdullah Bujupi , Isa Peli, Hate Shala, Ekrem Zogaj dhe Sefedin Berisha, kurse delegatë nga kjo komunë për Kongresin e SBASHK-ut u zgjedhën: Avdulla Bujupi, Ismet Shala, Hate Shala, Lirie Muhaxheri, Shaban Gashi, Besim Shatri dhe Elhame Nila. Në Këshillin Drejtues do të jenë: Besim Shatri, Besa Shala e Xhafer Avdyli me zëvendësuesit e tyre Fitnete Emra e Bajram Gashi.

Kuvendi ka zgjedhur edhe komisionin mbikëqyrës, anëtarë të të cilit janë : Elhame Nila, Ismet Uka dhe Vjollca Lluca.

Edhe në **Deçan** vërehej atmosferë festive dhe mobilizim i mirë që Kuvendi i SAF e SAM i kësaj



komune të shkojë mbarë. Kryetari Avdulla Lata ka prezantuar para pjesëmarrësve të këtij takimi raportin e punës dhe atë financiar e pas kësaj ka nisur procesi i zgjedhjeve përmes votës së fshehtë. Pas kësaj është filluar me kandidimin e pastaj edhe me votimin për kryetar, nënkryetar, anëtarë të kryesisë, përfaqësues në Këshillin Drejtues , anëtarë të Komisionit mbikëqyrës dhe për delegatë në Kongresin VII të SBASHK nga kjo komunë. Kuvendi i SAF e SAM për komunën e Deçanit me votim të fshehtë ka rizgjedhur për kryetar Avdull Latën, nënkryetar Fatmir Alaj dhe anëtarë të kryesisë Hazir Mehaj, Xhevat Shabanaj dhe Zenun Selmanaj.



Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës janë zgjedhur Haki Hulaj, Ramë Çekaj dhe Gjylshahe Bajramaj. Delegatë për Kongresin VII të SBASHK nga komuna e Deçanit do të jenë Hajrie Imeraj e Binak Mazdrekaj ,kurse përfaqësuese e sindikalistëve të Deçanit në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut do të jetë Hajrie Imeraj me zëvendësuesen e saj Zejnie Haxhaj.

Në **Podujevë**

Po ashtu edhe në Podujevë është mbajtur Kuvend i suksesshëm zgjedhor i SAF e SAM për këtë Komunë. Kryetari Fadil Halimi ka paraqitur fillimisht raportin e punës dhe atë financiar e pastaj ka nisur procesi zgjedhor për organet e këtij Kuvendi. Përmes votimit të lirë e të fshehtë kryetar është rizgjedhur Fadil Halimi, nënkryetar Isuf Kamerolli, ndërsa anëtarë të ri të kryesisë janë zgjedhur: Merita Fetahu, Vahide Bislimi, Burim Muzaqi, Zarife Latifi, Fahri Hoxha, Shaban Rudari dhe Fadil Zymberi.

Ky kuvend ka zgjedhur Ibrahim Selmanin, Ilhamedin Gashin dhe Baki Sadikun në Komisionin mbikëqyrës, Besim Gashin e Majlinda Rrmokun, me zëvendësit e tyre Melihate Januzi e Zeqir Zeqiri për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut dhe Bahtie Maqestena, Zarife Latifi, Fadil Zymberi e Fahri Hoxha për delegatë të kësaj komune për Kongresin VII të SBASHK-ut.

*Frymë e unitetit edhe në **Skenderaj***

Edhe në komunën e Skenderajt është mbajtur Kuvend i suksesshëm zgjedhor. Kryetari i këtij Kuvendi Ramiz Polaci ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe juristin Blendor Shatri duke i falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim e pastaj ka paraqitur raportin e punës dhe atë financiar për 4 vitet e kaluara.



Pas kësaj është kaluar në pjesën e dytë të punimeve të këtij Kuvendi dhe përmes votës së fshehtë e në një konkurrencë mjaft të madhe për secilën pozitë udhëheqëse për kryetar është rizgjedhur Ramiz Polaci, kurse nënkryetar Adem Hetemi. Kryesia e re ka këtë përbërje: Shpend Rexha, Shaban Lushtaku, Sefer Spahiu, Xhavit Behrami dhe Sylejman Hoxha. Këtë

komunë në Kongresin VII të SBASHK-ut do t'i përfaqësojnë Ferdane Mecini, Sefer Spahiu dhe Behlul Kodra. Anëtarë të Komisionit mbikëqyrës janë zgjedhur Abedin tahiri, Fadil Oruqi dhe Enver Fejza, kurse anëtarë të Këshillit Drejtues Afrim Ismajli, Vezire Sejdiu me zëvendësit e tyre Qezibane Pajaziti dhe Brahim Hamza.

Atmosferë e bukur e festive të shtunën në Kuvendin e SAF e SAM të Mitrovicës

Një atmosferë vërtetë festive është vërejtur gjatë punimeve të Kuvendit zgjedhor të SAF e SAM të Mitrovicës.



Kryetarja e Kuvendit të SAF e SAM për Mitrovicën, Vjollca Shala bashkë me kryesinë e këtij Kuvendi kishin bërë gjithë angazhimet në mënyrë që kjo ngjarje e veçantë të kishte vërtetë pamje të merituar e festive. Kryetarja Shala ka prezantuar raportin e punës duke rikujtuar shumë aktivitete sindikale që janë zhvilluar në komunën e Mitrovicës. Ajo pastaj ka prezantuar edhe raportin financiar duke u ndalur në çdo detaj.



Pasi që Kuvendi ka aprovuar të dy raportet dhe ka lavdëruar angazhimet e kryetares Vjollca Shala sëstë kaluar në procesin e zgjedhjeve. Pas numërimit publik të votave kanë dalë këto rezultate: Kryetare është rizgjedhur Vjollca Shala e nënkryetar Isa Ismajli. Anëtarë të kryesisë janë: Nexhmije Emimi, Ibrahim Ismajli, Arta Haxhimehmeti, Sejdi Aliu e Ferki Sinani. Komisioni mbikëqyrës nga tani ka këtë përbërje: Nexhmije Bislimi, Mustafë Murseli e Daut Hyseni. Komunë e Mitrovicës në Kongresin VII të SBASHK-ut do ta përfaqësojnë: Ferki Sinani, Bajram Shala,

Aida Hoti, Kadri Hasani, Shpresa Bajrami dhe naile Uka, kurse në Këshillin Drejtues : Naile Uka, Pranvera Haziri e Bajram Shaja me zëvendësuesit e tyre Magbule Rexhepi, Meribane Mustafa e Ferki Sinani.

Resekt i lartë për angazhimet e SBASHK-ut edhe në **Lipjan**.

Edhe në Lipjan është mbajtur Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM për këtë Komunë. Fillimisht kryetari Emrush Ahmeti ka paraqitur raportin e punës dhe atë financiar për kohën sa ai është në krye të deryrës së kryetarit të SAF e SAM për Lipjanin.



Pas kësaj ka filluar procesi i zgjedhjeve përmes votës së fshehtë. Në një konkurrencë të fortë për çdo detyrë udhëheqëse janë zgjedhur kryetari, nënkryetari , kryesia, delegatët e Kongresit të SBASHK-ut, Komisioni mbikëqyrës dhe përfaqësuesit nga Lipjani për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut. Kryetar është rizgjedhur Emrush Ahmeti e nënkryetar Xhevat Zeqiri. Kryesia e zgjedhur ka këtë përbërje: Haxhi Bajrami, Naim bahtiri, Artan Buja, Flamur Semetishi, Besnik Reçica, Hasime Greiçevci dhe Suzana Abdullahu. Komisionin mbikëqyrës e përbëjnë : Bihe Azemi, Ramadan Ismaili dhe Enver Llugiqi. Delegatë nga kjo komunë për Kongresin SBASHK-ut janë zgjedhur: Hasime Greiçevci, Metush Sinani, Feim Gashi, Elmaze Rashiti me zëvendësuesit eventual të tyre Sabrije Asllani, Xhemile Qamili e Idriz Sopa. Në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut punëtorët e arsimit të komunë së Lipjanit do të përfaqësohen nga Lutfije Ibrahimimi e Avdullah Krasniqi me zëvendësuesit eventual Miradije Rashiti dhe Qazim Zaskoku.

Në të gjitha këto Kuvende punë kanë marrë pjesë kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, të shoqëruar në disa takime edhe nga juristi Blendor Shatri.

Vlen të përmendet se në të gjitha këto Kuvende pjesëmarrësit kanë propozuar që Rrahman Jasharaj të zgjedhet kryetar i SBASHK edhe për një mandat.

SBASHK-u u takua me mësimdhënës dhe me kryetarin e Rahovecit z. Idriz Vehapi

Kryetari Vehapi shpreh respekt të lartë për angazhimet e SBASHK-ut

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj bashkë me këshilltarin për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe juristin Blendor Shatri kishin shkuar në Rahovec në një takim pune me anëtarët e Kuvendit të SAF e SAM të kësaj Komune. Ata fillimisht, të shoqëruar edhe nga kryetari i SAF e SAM për Rahovecin, Veli Morina, janë pritur në një takim nga kryetari i Rahovecit, Idriz Vehapi.

Kryetari i Rahovecit z. Vehapi ka lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut duke theksuar se vazhdimisht është munduar që përmes dialogut me përfaqësuesit e SBASHK-ut në këtë komunë të realizoi kërkesat brenda mundësive buxhetore. Ai ka premtuar që nëse del fitues në zgjedhjet e 22 tetorit dhe do ta udhëheq prapë Rahovecin, atëherë do të bëjë angazhime shtesë për plotësimin e kërkesave



legjitime të SBASHK-ut për këtë komunë. Përfaqësuesit e SBASHK-ut nga niveli qendror dhe ai komunal i kanë shprehur respekt për korrëktësinë ndaj mësimdhënësve të kësaj komune dhe i kanë kujtuar obligimet që kanë pushtetet lokale për ta realizuar në tërësi Kontratën Kolektive të arsimit të Kosovës.

Një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut për anëtarësinë

Përgatitje konkrete për udhëheqjen efektive të dialogut sindikal

Krahas aktiviteteve e angazhimeve të shumta në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u po vazhdon edhe me realizimin në tërësi të Planit Strategjik 2015-2019, plan ky i cili vend me rëndësi i jep përgatitjes së të zgjedhurve të ri për dialogun social.



Një aktivitet i tillë është zhvilluar nga data 14 shtator 2017 dhe për tri ditë me radhë pjesëmarrësit nga komunat e Kosovës, që janë zgjedhur të udhëhqin shoqatat sindikale në shkollat e tyre, ata kanë punuar në forcimin e kapaciteteve njerëzore për udhëheqjen efektive të dialogut social.

“Ky trajnim ka për qëllim që gjithë ata që janë zgjedhur kryetar për të parën herë nga shoqatat sindikale, të përgatiten për të udhëhequr me sukses dialogun social që nga shkolla me drejtorinë, në nivelin komunal me DKA-të dhe me qeveritë lokale e deri të dialogu me institucionet qendrore të Kosovës.



Në trajnimin e radhës, që ka filluar më 14 shtator, po marrin pjesë kryetarët e shoqatave sindikale nga disa shkolla fillore e të mesme të Pejës, Prishtinës, Gjilanit e Lipjanit dhe nga disa njësi akademike të UP-së”, ka treguar kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj. Trajneri i licencuar për dialogun social dhe njohësi i



mirë e çështjeve të organizimit sindikal , Ymer Ymeri ka nisur me trajnimin e radhës duke u ndalur në veçanti te "Definicioni për dialogun social", " Funksioni dhe sfidat e dialogut social", "Dialogu social në kontestin kombëtar dhe në atë ndërkombëtar".

Ai është ndalur për të bashkëbiseduar me pjesëmarrësit për të parë se si zhvillohet dialogu social në vende të ndryshme të Evropës de botës e po ashtu kanë analizuar edhe lidhur me mundësitë e zgjidhjes së konflikteve dhe gjetjen e zgjedhjeve të duhura për shumë nga çështjet sfiduese. Pjesëmarrësit e këtij aktiviteti dialogun nuk e kanë marrë të ndarë vetëm në aspektin social, por kanë marrë shembuj dhe janë angazhuar të gjejnë modelet me të mira të qasjes në dialogun me nxënësin, kolegët, me drejtorin dhe me prindërit dhe komunitetin në tërësi.

Një pjesë shumë dinamike e këtij trajnimi është ajo kur disa nga pjesëmarrësit gjenden në pozicionin e përfaqësuesit sindikal e pjesë tjetër në cilësinë e



përfaqësuesve të qeverisë lokale a asaj qendrore në përpjekje që përmes dialogut të gjejnë zgjidhje për çështjen e caktuar. Pjesëmarrësit për dijen e arritur dhe të dëshmuar në pjesën praktike të dialogut do të marrin certifikata të nënshkruara nga trajneri i licencuar për dialogun social, nga zyrtari i MASHT dhe nga kryetari i SBASHK-ut, kjo ngase ky trajnim është i licencuar në Ministria e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë.

Në suksesin e plotë të këtij trajnimi ka kontribuar edhe juristi i SBASHK-ut, Blendor Shatri.